



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 604, Datë 21.03.2019

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”.

Baza Ligjore: Neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, për periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 30 nëntor 2018, si dhe raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë ndërmarrjes nën hetim Bankers Petroleum Albania Ltd dhe ndërmarrjes ankuese Tosk Energji SHA, si dhe është kërkuar informacion nga këto ndërmarrje, nga Agjencia

Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), DPD dhe “Albpetrol” SHA. Nga informacioni i depozituar rezulton se mungojnë dokumente të rëndësishme për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjes nën hetim, gjatë procedurës së hetimit paraprak.

3. Bazuar sa më sipër si dhe për shkak të kohës së shkurtër të mbetur në dispozicion, nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar, me qëllim përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjes nën hetim Bankers, e cila operon në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto në vend, vlerësojmë të nevojshme zgjatjen e periudhës së hetimit paraprak me qëllim kryerjen e procedurave hetimore dhe përgatitjen e raportit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, afati i përcaktuar në pikën “III”, shtyhet me 2 (dy) muaj.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS